



## **Rubrika mbi Pyetjet dhe Përgjigjet më të shpeshta të përcjella deri në dt. 13 Shtator 2024**

### ***1. Si është bërë publikimi i thirrjes për nëngrante?***

Publikimi i thirrjes është realizuar me anë të faqes zyrtare të internetit dhe faqes Facebook të KShH-së dhe organizatave partnere, Facebook të “Qendrës Kombëtare Burimore të Shoqërisë Civile” si dhe Facebook të Rrjetit Kombëtar kundër Korrupsionit “Shoqëria Civile kundër Korrupsionit”. Gjatë afatit të vlefshmërisë së thirrjes, ajo po promovohet në një periudhë 6 ditore në tre gazeta të printuara si Gazeta Panorama, Gazeta Tema dhe Gazeta Dita. Gjithashtu, lidhur me këtë thirrje janë zhvilluar tre sesione të dedikuara informuese në Tiranë (10 Shtator), Shkodër (11 Shtator) dhe Vlorë (12 Shtator 2024), me pjesëmarrjen e organizatave jofitimprurëse.

Të gjitha njoftimet e tjera për aplikantët e interesuar gjatë periudhës së aplikimit dhe procedurës së vlerësimit do të publikohen rregullisht në faqen zyrtare të KShH, ndaj sugjerojmë që ajo të konsultohet në mënyrë të rregullt: [www.ahc.org.al](http://www.ahc.org.al). Çdo komunikim i ri lidhur me thirrjen, do të publikohet njëkohësisht në FB e KShH-së.

### ***2. Shtrirja e gjeografike e aplikimeve është vetëm për qytetet ku janë zhvilluar sesionet e informimit (në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë) apo për të gjithë territorin?***

Kjo skemë inkurajon ideimin e projekteve vendore që kanë në fokus nga pikëpamja e shtrirjes gjeografike, një ose disa bashki të vendit, pa asnjë kufizim gjeografik.

Arsyeja se përse janë përzgjedhur tre qytete në pjesën veriore, të mesme dhe jugore të vendit, është në funksion të promovimit sa më të gjerë të skemës së nën-granteve, por kjo nuk nënkupton dhënien e përparësisë apo përjashtimit të organizatave që janë themeluar dhe shtrijnë veprimtarinë e tyre në qytete të tjera të vendit.

### ***3. Kemi vështirësi për të siguruar dëshmitë e penalitetit të anëtarëve të organeve vendimmarrëse për shkak se një pjesë e tyre kanë më shumë se një shtetësi ose ndodhen jashtë vendit? Si duhet të veprojmë?***

Duke nisur nga vështirësitë e shfaqura gjatë sesioneve të informimit për këtë thirrje, nga disa prej organizatave të shoqërisë civile, është vendosur të lehtësohet kriteri dëshmisë së penalitetit vetëm për anëtarët e organeve vendimmarrëse të organizatave aplikuese. Rrjedhimisht, ky nuk do të jetë një kriter i detyrueshëm, me kushtin që drejtorët ekzekutivë ose përfaqësuesit ligjorë të

organizatave, të paraqesin një deklaratë të nënshkruar dhe vulosur ku deklarojnë me vullnet të lirë dhe përgjegjësi të plotë, gjendjen gjyqësore të secilit prej anëtarëve të organeve vendimmarrëse. Pra në këtë deklaratë do të listohen emrat dhe mbiemrat e tyre dhe specifikohet nëse janë ose jo shtetas të padënuar ose të dënuar. Nëse ka shtetas të dënuar, në këtë deklaratë duhet të shënohet vepra penale për të cilën janë dënuar, lloji dhe masa e dënimit dhe të dhënat për vendimin gjyqësor të dënimit të formës së prerë (numri, data dhe gjykata që e ka dhënë).

Në çdo rast, mbetet një kërkesë e detyrueshme e kësaj thirrje, paraqitja e dëshmisë së penalityt të përfaqësuesit ligjor (drejtorit ekzekutiv) të aplikantit kryesor ose organizatës lider, e cila mund të gjenerohet nga sistemi e-albania, pasi të jetë bërë në këtë sistem aplikimi për lëshimin e këtij dokumenti.

***4. Organizata që unë përfaqësoj e ka selinë në Bashkinë e Selenicës dhe për të marrë kopjen e ekstraktit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë më nevojiten dy ditë pune dhe kam kosto financiare të cilat nuk i përballoj dot. Si duhet të veproj?***

Sipas seksionit 2.2 të Udhëzuesit është kriter i detyrueshëm për pjesën e dokumentacionit, dorëzimi i kopjes origjinale të ekstraktit të gjykatës për organizatën aplikuese, në formë të skanuar, i lëshuar nga gjykata brenda 3 muajve të fundit nga data e aplikimit për këtë thirrje për nëngrante. P.sh nëse ju paraqisni një aplikim në dt.20 Shtator, data e ekstraktit duhet të jetë në periudhën 20 Qershor - 20 Shtator 2024.

Megjithatë, duke patur në konsideratë vështirësitë objektive të adresuara nga organizatat, është vendosur të lehtësohet ky kriter dhe të paraqitet kopja ose origjinali i ekstraktit të gjykatës, në variantin e skanuar i cili ka një datë të mëhershme se periudha tre mujore e vlefshmërisë, e parashikuar në thirrje.

Lutem mbani në konsideratë se nëse projekt propozimi përzgjidhet përkohësisht, pas kalimit me sukses së fazës së dytë të vlerësimit, kriteri për dorëzimin e ekstraktit origjinal të gjykatës brenda afatit tremujor të vlefshmërisë të shpjeguar më sipër është i detyrueshëm.

***5. Në rast se nuk kam një dokument të detyrueshëm të kërkuar sipas seksionit 2.2 të Udhëzuesit të Thirrjes, si mund të veproj?***

Nëse organizata lider (aplikanti kryesor) është në kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar një dokument të detyrueshëm, sipas seksionit 2.2 të Udhëzuesit të Thirrjes, kjo mungesë duhet të shpjegohet nën kolonën “komente” në Formatin e Listës së Kontrollit, në Aneksin nr.1 që është pjesë e paketës së aplikimit . Mungesa e një dokumenti të detyrueshëm sipas udhëzuesit sjell skualifikim të projekt propozimit në fazën e parë. Megjithatë, në varësi të shpjegimit të dhënë nga aplikanti dhe në frymën e një procesi garues sa më gjithëpërfshirës, Sekretariati Teknik që është përgjegjës për fazën e parë të kontrollit administrativ, ndjek një politikë të unifikuar dhe mund t’i kërkojë aplikantëve të plotësojnë dokumentacionin deri në dt.8 Tetor 2024, duke i vendosur në dispozicion një afat plotësimi jo më shumë se pesë ditë pune nga njoftimi. Nëse

aplikanti nuk plotëson sërish dokumentacionin e kërkuar, dhe kjo mungesë nuk justifikohet ligjërisht, projekt propozimi refuzohet (skualifikohet).

**6. Organizata që drejtoj në vitin 2023 ka qene pasive dhe në 2024 është bërë aktive sërish. A pëbën kjo nje kriter skualifikues në kuptim të dokumentacionit të kërkuar pasi ne nuk disponojmë pasqyra financiare per vitin 2023?**

Në këto raste është e këshillueshme që mungesa e dokumentacionit të shpjegohet në rubrikën Komete, të Formatit të Listës së Kontrollit, në Aneksin nr.1 që është pjesë e paketës së aplikimit. Nisur nga pamundësia objektive e organizatës për të patur një dokument të tillë, është e këshillueshme të paraqiten pasqyrat financiare të vitit më të fundit, kur organizata ka patur aktivitet financiar me kushtin që kjo e fundit nuk është subjekt i procedurave të falimentimit ose mbylljes. Nëse organizata është krijuar në vitin 2024, sërish kjo mungesë duhet të shpjegohet sipas orientimeve të dhëna më sipër.

Në rastet e mungesave objektive të dokumentacionit dhe të justifikuara ligjërisht sipas legjislacionit tonë në fuqi, vendimmarrja lidhur me to i takon Sekretariatit Teknik, që ndjek një politikë të unifikuar dhe të udhëhequr nga parimi i garës gjithëpërfshirëse e të ndershme. Lutem mbani në konsideratë se Vendimi i Sekretariatit Teknik është i ankimueshëm pranë Komitetit të Vlerësimit të Ankimeve, brenda tre ditëve nga data e njoftimit të vendimmarrjes së fazës së parë, sipas orientimeve të dhëna në Seksionin nr.6 të Udhëzuesit.

**7. A është e nevojshme per ne si aplikues që të dorëzojmë marrëveshje me institucionet publike me te cilat propozojmë të punojmë për të përmbushur objektivat e projektit?**

Ky dokument nuk parashikohet në listën e dokumentave të domosdoshëm sipas seksionit 2.2 dhe formatet e aplikimit sipas seksionit 3.1 të Udhëzuesit të Thirrjes. Aplikimi për këtë thirrje nuk kërkon paraqitjen e anekseve apo formateve të tjera të dokumentacionit, tej atyre të listuara në seksionet 2.2 dhe 3.1 të saj.

**8. Përvec dokumentave të aplikimit sipas formateve të listuara nën Anekset I, II, III, IV, V, VI, VII a duhet që edhe dokumentat e tjera shoqëruese të renditura nën seksionin 2.2 të jenë në gjuhën angleze?**

Vetëm formatet e detajuara në anekset shoqëruese të udhëzuesit duhet të jenë në gjuhën angleze.

Sa i takon dokumentacionit të detyrueshëm që bashkëshoqëron aplikimin, i listuar në seksionin 2.2, kërkohet në gjuhën angleze vetëm CV e organizatës. Dokumentat e tjerë në të renditura në këtë seksion mund të paraqiten në gjuhën e tyre zyrtare në të cilën janë hartuar e mbajtur (gjuhën shqipe).

**9. A duhet të kemi një bashkë aplikant për të aplikuar?**

Bashkë aplikimi nuk është kriter i detyrueshëm i kësaj thirrjeje. Bashkë-aplikimi me organizata të tjera të shoqërisë civile ose përfshirjen e personave të lidhur (affiliated), inkurajohet me qëllim që projektet fituese të kenë një shirrje sa të gjerë gjeografike.

***10. A mundet një aplikant kryesor, organizatë partnere apo person i lidhur (affiliated) të aplikoj dy here ose me shumë në këtë thirrje?***

Aplikanti kryesor, organizata partnere apo personi i lidhur **mund të aplikojnë vetëm një herë** në këtë thirrje. Në të kundërt aplikimi refuzohet ose do të skualifikohen në fazën e parë të verifikimit administrativ të projekt-propozimeve.

***11. Bashkë aplikanti ose organizata/t partnere duhet të jetë organizatë jofitimprurëse apo mund të jetë dhe një institucion?***

Bashkë-aplikanti duhet të jetë një organizatë jofitimprurëse që plotëson të njëjtat kriterë legjitimiteti si aplikanti kryesor të parashikuara në seksionin 2.1 të Udhëzuesit për thirrjen. Lutem gjithashtu mbani në konsideratë se bashkë aplikanti, njëjtë si aplikantët kryesorë dhe personat e lidhur nuk duhet të jenë në një nga rrethanat skualifikuese të parashikuara në pikën 2 të këtij seksioni.

***12. Po personi i lidhur (affiliated person) a duhet të jetë organizatë jofitimprurëse?***

Personi i lidhur nuk duhet të jetë detyrimisht një organizatë jofitimprurëse por mund të jetë person fizik ose juridik, që kontribuon për zbatimin e projektit, për shkak të ekspertizës apo fushës së kompetencave (si për shembull ekspertë të fushës, organe të qeverisjes vendore, institucione të pavarura, universitetet, etj). Edhe personi i lidhur, pavarësisht nga statusi i tij, nuk duhet të jetë në kushtet ndaluese (skualifikuese) të parashikuara në pikën 2 të seksionit 2.1 të udhëzuesit të thirrjes.

***13. A duhet të paraqesim në fazën e aplikimit dokumentat e kërkuara për aplikantin kryesor (organizatën lider) edhe për organizatën/at bashkë-aplikante dhe personin/at e lidhur?***

Listë e dokumentave të kërkuara në seksionin 2.2 të udhëzuesit të thirrjes, **në fazën e aplikimit** është e detyrueshme vetëm për aplikantin kryesor (organizatën lider). Për organizatën bashkë-aplikante është e detyrueshme të plotësojë dhe nënshkruajë Aneksin VII “Deklarata e Bashkë Aplikantit”.

Pas mbylljes së periudhës së aplikimit, vetëm nëse projekt propozimi përzgjidhet përkohësisht, pas kalimit me sukses së fazës së dytë të vlerësimit, organizatës lider (aplikantit kryesor) do t’i kërkohej të vendosë në dispozicion të Komisionit të Vlerësimit, të gjithë dokumentat fizike të kërkuara në seksionin 2.2 për organizatën lider dhe organizatën/at bashkëaplikuese, në variantin

original ose kopje të noterizuar, me qëllim që të vlerësohet në mënyrë sa më të saktë pajtueshmëria me kriteret e legjitimitetit, sipas kriterëve të parashikuara në seksionin 2.1 të udhëzuesit për këtë thirrje. Gjithashtu, do t'i kërkohet për personin e lidhur (nëse ka një të tillë) të nënshkruhet një format i ngjashëm me Aneksin VII të udhëzuesit.

***14. Në propozimin e projektit a duhet të adresohen të dy objektivat e thirrjes apo mund të zgjedhim njërin prej tyre?***

Organizatave aplikuese janë të lira të propozojnë projekte që adresojnë ose një prej objektivave specifike ose të dy së bashku, në përputhje me misionin dhe fushën e ekspertizës së tyre.

***15. A duhet të aplikojnë vetëm OJF-të që në veprimtarinë e tyre, apo misionin e tyre kanë fokus çështjet e Drejtësisë, Anti-korrupsionit dhe Mirëqeverisjes?***

Thirrja nuk parashikon kriterë penguese për organizatat që nuk kanë drejtpërsëdrejti në objekt të veprimtarisë apo misionit të tyre objektivin e përgjithshëm apo ato specifike të saj, pasi çështjet e drejtësisë, anti-korrupsionit dhe mirëqeverisjes mund të jenë fusha të ndërlidhura me fushat parësore që janë në misionin parësor të këtyre organizatave.

Vlen të theksohet që pjesë e formatit të vlerësimit teknik të projekt propozimeve që kalojnë me sukses fazën e parë, konkretisht nën seksionin një të këtij formati, është edhe përvoja dhe ekspertiza e mjaftueshme teknike e organizatave në fushën e projekt propozimit.

***16. Buxheti është vetëm për organizatën lider apo dhe mund të ndahet me organizatën/at bashkëaplikuese? A duhet të ketë një marrëveshje për ndarjen e buxhetit në fazën e aplikimit?***

Aplikanti kryesor është përgjegjëse për të parashikuar në formatin e buxhetit, sipas aneksit V (forma e buxhetit të aplikimit), të gjitha kostot që i përkasin zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në kuadër të ndërhyrjes së propozuar, duke përfshirë këtu edhe kostot që i përkasin bashkë aplikantit. Thirrja nuk kërkon paraqitjen e një dokumenti “marrëveshje” apo çdo dokument tjetër për ndarjen e buxhetit midis partnerëve. Nëse projekt-propozimi deklarohet fitues, në fazën e zbatimit organizata lider lidh marrëveshje ose kontrata bashkëpunimi me organizatën/partnere për ndarjen e kostove, sipas aktiviteteve që ato do të zbatojnë dhe në përputhje me linjat përkatëse buxhetore të buxhetit të miratuar nga Autoriteti Kontraktues.

***17. Kur pritet të fillojë zbatimi i projekteve, me qëllim që të ndërtojmë një plan aktiviteteve sa më realist?***

Sipas tabelës me afatet orientuese të parashikuara në seksionin nr.5.2 të Udhëzuesit, nënshkrimi i kontratës pritet të realizohet në dt.1 Dhjetor 2024 që shënon edhe datën zyrtare të fillimit të zbatimit të aktiviteteve.

Megjithatë, duke qënë se kjo tabelë parashikon afate orientuese, në rast të shtyrjes së këtyre afateve, ato do të publikohen në faqen zyrtare dhe Facebook të KShH. Në këtë rast, organizatat fituese do të përshtasin planin e aktiviteteve të kushtëzuar me datën e re të nënshkrimit të kontratës.

***18. A njihen kostot e TVSH-së (20%) pasi ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian?***

Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) nuk rimburohet nga skema e granteve dhe e nëngranteve të financuara nga Bashkimi Evropian, duke përfshirë edhe skemën e nën granteve që është pjesë e kësaj thirrjeje. Si rrjedhojë, organizatat jofitimprurëse përfituese të kësaj skeme është e këshillueshme të ndjekin procedurat ligjore në fuqi për rimbursimin e TVSH-së nga shteti, pasi të kenë marrë informacion të saktë mbi rrugët ligjore nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ose Institucionet në varësi të saj.

***19. Parashikohet që 25% të mbulojnë pagat, po 7% cfare duhet të përfshijë?***

Në faqen 12 të Udhëzuesit parashikohen kostot që nuk janë të lejuara apo legjitime. Sipas tyre, mbulimi i pagave të stafit të angazhuar në projekt (si pjesë e burimeve njerëzore) nuk duhet të tejkalojë 25% të vlerës totale të buxhetit, ndërkohë që kostot administrative që njihen ndryshe si kostot indirekte nuk duhet të tejkalojnë 7% të vlerës totale të buxhetit. Kostot indirekte përfshijnë shpenzimet operative dhe administrative të Aplikantit kryesor dhe Partnerëve të Projektit të tilla si kosto të qerasë së zyrës, shërbimet e dobishme të zyrës (energji elektrike, ngrohje, ujë), pajisje zyre (kancelari), kosto mirëmbajtjeje dhe pastrimi, mirëmbajtja e sistemit të Teknologjisë së informacionit, Komunikimi (telefon, shërbim postar), etj. Kostot indirekte nuk mund të raportohen njëkohësisht në kostot direkte të projektit. Për kostot direkte, organizatat duhet të mbajnë në konsideratë kufizimet e parashikuara në faqen 12 të udhëzuesit për këtë thirrje.

***20. A lejohet përfshirja e kostos për personat që kanë shkruajtur projektin në buxhetin e projektit?***

Kostot direkte të projektit nuk parashikojnë një kosto të tillë. Gjithashtu, kjo nuk justifikohet nga kostot e lejuara të shpjeguara në faqet 11-12 të projektit, të cilat janë vetëm ato që kanë ndodhur gjatë periudhës së zbatimit të projektit dhe jo në fazën ideuese të tij.

***21. A është e nevojshme të ketë një Asistent finance projekti?***

Përcaktimi i pozicioneve të burimeve njerëzore që janë të nevojshme për të koordinuar dhe/ose asistuar dhe ose mbikqyrur zbatimin e projektit është në përgjegjësi të organizatave aplikante të cilat duhet të mbajnë në konsideratë kriteret për legjitimitetin e kostove të paraqitura në faqet 11-12 të Udhëzuesit, në të cilën specifikohet se kostot e pranueshme do të konsiderohen ato kosto të cilat janë të identifikueshme dhe të verifikueshme, veçanërisht duke u regjistruar në regjistrat kontabël të përfituesve të nëngranteve dhe të përcaktuara sipas standardeve të kontabilitetit dhe praktikave të zakonshme të kontabilitetit të kostos të zbatueshme.

Gjithashtu është e rëndësishme që përcaktimi i nivelit të pozicionit/eve që do të angazhohen në cilësinë e burimeve njerëzore, të shoqërohet me një kostim që në total nuk tejkalon vlerën 25% të buxhetit total, si dhe këto kosto i përgjigjen nivelit të pagave të stafit të organizatave aplikuese, konform kontratave të punës dhe politikave të brendshme të pagave të tyre.

***22. A është e kosto e pranueshme të kryhen shpenzime për median për realizimin e këtyre aktiviteteve?***

Kjo nuk është një kosto e ndaluar (jo legjitime) dhe mund të përfshihet në kostot direkte të projektit nëse është e nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të projektit dhe përbën kosto reale, të arsyeshme dhe të justifikuar.

***23. Si duhet të dërgohet aplikimi?***

Aplikimet do të dërgohen me email në adresën elektronike si vijon:

[Subgrants.Application@ahc.org.al](mailto:Subgrants.Application@ahc.org.al)

Titulli i emailit ku dërgohet aplikimi do të përmbajë togfjalëshin “Aplikim për Thirrjen për propozime - **Emri i plotë i Aplikantit Kryesor**”. Dokumentat e detyrueshëm dhe formatet e aplikimit sipas anekseve të thirrjes do t’i bashkëngjiten me attach emailit ku dërgohet projekt aplikimi. Të gjitha dokumentat do të dërgohen në formatin elektronik. Inkurajohet dërgimi i formatit të skanuar ose PDF i kopjeve origjinale ose të noterizuara (ose në pamundësi i kopjeve të thjeshta) të dokumenteve që përmbajnë vulën, nënshkrimet dhe datën (në varësi të llojit të tyre, sidomos kur këto dokumenta janë të institucioneve shtetërore).

Pjesë e tekstit të emailit me anë të të cilit dërgohet projekt propozimi duhet të jenë këto elementë:

- Qartësimi se ky email dërgohet si pjesë e thirrjes për propozime “Shoqëria Civile kundër Korrupsionit - nga një sfidë vendase në një përgjigje evropiane”.
- Saktësimi i numrit të referencës të thirrjes I - EuropeAid/174080/DD/ACT/
- Emri i plotë i Aplikantit kryesor dhe Bashkë Aplikantit apo Bashkë Aplikantëve (nëse ka më shumë se 1.
- Titulli i projekt aplikimit
- Adresa e Aplikantit kryesor

***24. Në rast se emaili në të cilin dërgojmë propozimin ngarkohet si rrjedhojë e volumit të dokumentave si mund të veprojmë?***

Në këto raste është e këshillueshme ndarja e dokumentave në 2-3 emaile ose edhe më shumë nëse është nevoja. Sugjerohet që në titullin emailit të shtohet në vijim të togfjalëshit të sugjeruar më sipër, numri rendor i emailit psh “Aplikim për Thirrjen për propozime - **Emri i plotë i Aplikantit kryesor\_Nr.1**”. Gjithashtu, në funksion të sigurisë është e këshillueshme që në “cc” ose “bcc” të emailit me anë të të cilit ju dërgoni projekt propozimin, të vendosni një adresë të dytë tuajën të emailit për të verifikuar me anë të saj marrjen ose jo të projekt propozimit.

Ne do ti përgjigjemi emailit tuaj brenda një dite nga data e dërgimit, nga e njehta adrese ku është përcjellë [Subgrants.Application@ahc.org.al](mailto:Subgrants.Application@ahc.org.al) duke j'u komunikuar me anë të saj, numrin rendor të aplikimit tuaj.

***25. Sa projekte (organizata) do të jenë fituese?***

Ndarja e parashikuar e buxhetit total të planifikuar për të mbështetur skemën e nën-granteve për këtë thirrje do të mundësojë mbështetje deri në 6 projekt propozime, duke u kushtëzuar nga renditja e organizatave fituese dhe buxhetet përkatëse që do të miratohen për projekt-propozimin e tyre.

***26. A mund të kemi një përgjigje në fund se cilat organizata do të jenë fituese dhe nga cilat zona do të jenë?***

Pasi procesi i vlerësimit të ketë përfunduar dhe vendimi i Komitetit të Vlerësimit të jetë përfundimtar, organizatat fituese dhe vendet ku do të shtrihen gjeografikisht projekt propozimet e tyre do të bëhen publike në faqen zyrtare dhe Facebook të KShH si dhe Rrjetit Kombëtar kundër Korrupsionit “Shoqëria Civile kundër Korrupsionit”.